



RAPORTI

I AUDITUESIT TE PAVARUR

MBI PERDORIMIN E FONDEVE TE PERFITUARA E TE PERDORURA

PER VITIN KALENDARIK 2011

PARTIA "LIDHJA KOMBETARE SHQIPTARE"

Rruga "Çerçiz Topulli," nr. 8, Tirane

RAPORTI I AUDITUESIT

Komisionit Qendror te Zgjedhjeve,

Pallati i Kongreseve, Tirane

Të nderuar zotërinj,

Unë, Agim Lleshi, Ekspert Kontabël të Regjistruar, bazuar në Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, kam marre misionin për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara për vitin kalendarik 2011 të partisë "Lidhja Kombetare Shqiptare".

Pas marrjes së misionit kam hartuar programin e punës së auditimit të këtij subjekti politik, duke planifikuar kohën e domosdoshme për kryerjen e auditimit në përputhje të plote me Ligjin nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", Standartet Nderkombetare të Auditimit, kryesisht SNA 800, Ligji nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të Ekspertit Kontabël të Regjistruar dhe të Kontabilistit të Miratuar" dhe çdo akti nënligjor në zbatim të ligjeve të mesiperm.

Për të marrë kontakt me subjektin politik, pas nënshkrimit të kontratës së auditimit me KQZ-në, kam bërë përpjekjet e mëposhtme, por nuk munda të gjej as seline e partisë dhe as kryetarin e saj Z. Ismet Mehmeti.

- Se pari, pas marrjes së angazhimit hyra në internet për të gjetur ndonjë Web të partisë "Lidhja Kombetare Shqiptare", por nuk kishte.
- Se dyti, u interesova në Gjykatën e Tiranës dhe nëpërmjet sekretarise së saj arrita të gjej adresën e kësaj partie, sipas Vendimit të Gjykatës për themelimin e saj. Adresa ishte : "Rruga Çerçiz Topulli, Nr. 8, Tirane. Kryetari i Partisë, Ismet Mehmeti.
- Se treti, mbi bazën e kësaj adrese jam interesuar në këto lagje dhe rrugë, por nuk kam mundur të gjej as Seline e partisë "Lidhja Kombetare Shqiptare" e as z. Ismet Mehmeti.
- Se katërti, kam kërkuar në numërorin telefonik të qytetit të Tiranës dhe nuk kam identifikuar ndonjë numër telefoni e as person që lidhet me kryetarin e kësaj partie.
- Se gjashti, në faqen elektronike të KQZ-s nuk kam mundur të gjej ndonjë informacion me tepër se emrin e kryetarit të kësaj partie për kontaktuar me të e për të vazhduar me tej procedurat e auditimit.

Në këto kushte, të mungesës së evidencës së auditimit, duke mos e çuar misionin e marrë deri në fund, unë nuk mund të shpreh ndonjë opinion lidhur me përfitimin e fondeve dhe përdorimin tyre për vitin kalendarik 2011 nga partia "Lidhja Kombetare Shqiptare".

Tirane date 05/06/2012

Adresa :
Lagjia "28 nëntori" Rr. "11 Janari"
Pallati 422/7, kati i II-te
Elbasan
Cel: 0692084209

Ekspert Kontabël të Regjistruar
AGIM LLESHI

EKSPERT KONTABEL
* I AUTORIZUAR *
AGIM LLESHI
ELBASAN
CEL: 0692084209